



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 38 (827685)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 Shtator 2020

## Komandanti i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë



### Gjenerallejtënant Cavoli: Shqipëria një partner besnik ndaj SHBA-së

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi më 17 shtator 2020, një video-konferencë me gjenerallejtënant Christopher G. Cavoli, komandant i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë. Takimi vjen në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve

sidomos projekteve për modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por edhe stërvitjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, që kjo komandë do të zhvillojë në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit gjatë vitit 2021. Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak...

» faqe 2

## KJO DITË PËRKON ME 55-VJETORIN E BATALIONIT TË MBËSHTETJES

### Ministrja Xhaçka gradon gjeneral brigade Arben Kingji



» faqe 4

# Ministrja Xhaçka takon drejtuesit e rinj të Shtabit të Përgjithshëm të FA Investime në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunim me aleatët e partnerët

Xhaçka: “Kompensimi i ushqimit për 4000 efektivë të FA është një hap i parë i rëndësishëm drejt një trajtimi më dinjitoz e më vlerësues të kujtdo që shërben në FA”

» faqe 3



## Përfundon stërvitja “Carpathian Eagle 20”

Nga data 14 deri më 25 shtator 2020 në rajonin stërvitor Joint National Training Center në Cincu, Rumani u zhvillua stërvitja “Carpathian Eagle 20”. Kjo stërvitje u realizua me pjesëmarrjen e 6 vendeve të Ballkanit: Shqipëri, Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi, Maqedoni e Veriut. Stërvitje u zhvillua në nivel grupi special dhe shtab STOG, i cili ishte i përzier me personel nga të gjitha vendet...



» faqe 4

## Batalioni III i Këmbësorisë (b3k)

### Zhvillohet stërvitja 72 orëshe “Shqiponja Paqësore 20”

Batalioni III i Këmbësorisë (b3k) nga data 15 deri më 17 shtator, zhvilloi stërvitjen 72 orëshe “Shqiponja Paqësore 20”. Kjo stërvitje kryhet për të testuar dhe përmirësuar kapacitetet për kryerjen e detyrave në kuadër të operacioneve të mbështetjes së paqes si dhe ruajtjes së gatishmërisë. Stërvitja u zhvillua në nivel kompanie, ku efektivët pjesëmarrës të Kompanisë III të b3k realizuan skenarë...

» faqe 7

## NATO-2030

Stoltenberg:  
NATO-2030 ka të bëjë me të ardhmen e Aleancës

» faqe 8

## TAKIMI I SHEFAVE TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Gjeneralmajor Bajram Begaj në sesionin e 184 të Komitetit Ushtarak të NATO-s

» faqe 3

## AUTORE USHTARAKË

“I fundmi gjeneral partizan” ose 100 vite në një libër

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ » faqe 6



Komandanti i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë

# Gjenerallejtënant Cavoli: Shqipëria një partner besnik ndaj SHBA-së

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj: “SHBA mbetet partneri më strategjik i Shqipërisë, i mbështetur në një histori të gjatë miqësie dhe partneriteti”*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi më 17 shtator 2020, një video-konferencë me gjenerallejtënant Christopher G. Cavoli, komandant i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë. Takimi vjen në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve sidomos projekteve për modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por edhe stërvitjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, që kjo komandë do të zhvillojë në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit gjatë vitit 2021.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve duke theksuar se “SHBA mbetet partneri më strategjik i Shqipërisë, i mbështetur në një histori të gjatë miqësie dhe partneriteti”. Bashkëpunimi ushtarak midis Shqipërisë dhe SHBA-shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, stërvitjes, modernizimit, logjistikës dhe misioneve me kontingjentë të përbashkët në Kosovë, Irak dhe Afganistan, ku forcat amerikane dhe shqiptare kanë luftuar krah për krah njëri tjetrit.

Gjenerallejtënant Cavoli vlerësoi rolin e Shqipërisë si partner besnik ndaj SHBA, si dhe shprehu gatishmërinë për mbështetjen për projektet në vazhdim dhe eksplorimin e fushave të reja të bashkëpunimit sidomos në atë të trajnimit të personelit për pajisjet e sistemet e dhuruara nga SHBA, por edhe stërvitjeve për rritjen e interoperabilitetit dhe testimin e gatishmërisë së forcave dhe pajisjeve.

Shqipëria do të jetë një nga vendet mikpritëse të stërvitjes “Defender-21”, e cila është stërvitja më e madhe e SHBA por edhe NATO për 2021, në kontinentin evropian.

Të dy bashkëbiseduesit diskutuan për situatën aktuale të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe rëndësinë e ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në këtë rajon. Në këtë kuadër u vlerësua roli i SHBA si palë në disa nga forumet e sigurisë në rajon si Adriatik Charter (A - 5), mbështetja e saj për integrimin e disa nga vendeve në strukturat euroatlantike dhe bashkëpunimi i suksesshëm dypalësh për të promovuar vlerat e lirisë dhe paqes në rajon.

Gjenerallejtënat Cavoli uroi gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj për marrjen e detyrës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe të dy shprehën edhe njëherë gatishmërinë për vijueshmërinë e bashkëpunimit ushtarak midis palëve.



Komisioni për Sigurinë Kombëtare zhvilloi më 18 shtator 2020, një vizitë njohëse në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me rastin e emërimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj. Qëllimi i vizitës ishte njohja me vizionin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në drejtim të Forcave të Armatosura, për periudhën 2020-2023, ecurinë e punës së deritanishme dhe problematikën e FARSH.

Kryetarja e Komisionit, Znj. Ermonela Valikaj (Felaj), pasi bëri fillimisht një prezantim të anëtarëve të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, falënderoi SHSHP për punën e bërë nga efektivat e Forcave të Armatosura në përmbushje të misionit të tyre për ruajtjen dhe sigurinë kombëtare.

Më pas, takimi vijoi me një prezantim nga Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Ilir Pujo, mbi misionin, detyrat, punën e deritanishme, pjesëmarrjen në misione dhe operacione ndërkombëtare, projektet e modernizimit dhe vizionin e SHSHP për FARSH.

Anëtarët e komisionit treguan interes të veçantë në disa çështje të caktuara, për të cilat adresuan dhe disa pyetje. Disa nga këto çështje kishin të bënin me: kursin e Pilotit në Forcën Ajrore, sistemin arsimor të ushtarakëve, punën e personelit të Qendrës Ndërinstitucionale

Komisioni për Sigurinë Kombëtare mbështet punën e FARSH

## Proгноza 2020-2023, ecuria e punës dhe problematika e FARSH



Operacionale Detare (QNOD), përfshirjen e grave në FARSH bazuar edhe në direktivat e Rezolutës 1325, projektet e modernizimit dhe pronat.

Në përfundim të prezantimit Znj. Felaj falënderoi Shefin e Shtabit të Përgjithshëm për pritjen dhe e siguroi atë se Komisioni është i gatshëm të mbështesë punën e FARSH për realizimin me sukses të objektivave të tyre sipas prioritetëve që

Shtabi i Përgjithshëm ka vendosur.

SHSHP, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, falënderoi Kryetaren e Komisionit, znj. Ermonela Felaj dhe anëtarët për vizitën e tyre duke theksuar më tej se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi dhe mbështetja e Komisionit për Sigurinë Kombëtare në çuarjen më tej të punës së Forcave të Armatosura.



## Ministrja Xhaçka takon drejtuesit e rinj të Shtabit të Përgjithshëm të FA

## Investime në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunim me aleatët e partnerët

*Xhaçka: “Kompensimi i ushqimit për 4000 efektivë të FA është një hap i parë i rëndësishëm drejt një trajtimi më dinjitoz e më vlerësues të kujtdo që shërben në FA”*

Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë një staf të ri drejtues, pas emërimit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneral-major Bajram Begaj. Në një takim me drejtuesit e rinj të Shtabit të Përgjithshëm të FA, zhvilluar më 19 shtator 2020, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka foli për vizionin e një FA moderne, të ndërtuar mbi meritokracinë e profesionalizmin për t'i dhënë standartet që i takon një vendi anëtar të NATO.

Sipas ministres Xhaçka, FA sot operon me dinjitet e standarde krah për krah ushtrive më të fuqishme në botë në misione nga Afganistani e deri në Mali.

Reformimi i emergjencave civile, modernizimi përmes investimeve në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimit me aleatët e partnerët, arsimimi dhe trajnimi financiar i FA janë renditur nga ministrja e Mbrojtjes si disa prej fushave ku janë shënuar hapa të rëndësishëm e me rezultate pozitive e me impakt të drejtpërdrejtë në atë që Forcat e Armatosura janë sot. “Ia kemi dalë të rrisim trajtimin financiar dhe të rikthejmë kompensimin e ushqimit për 4000 efektivë të FA. Çka padyshim nuk mjafton, por është një hap i parë rëndësishëm drejt një trajtimi më dinjitoz e më vlerësues të kujtdo që shërben në FA”, - theksoi ministrja e Mbrojtjes. Ajo kërkoi nga stafi i ri bashkëpunim dhe përkushtim për të rritur profesionalizmin në rradhët e FA, që shumë shpejt do të hapë dyert për herë të parë për të gjithë ata të rinj që duan të ndjekin studimet për shkenca ushtarake.



*FA sot operon me dinjitet e standarde krah për krah ushtrive më të fuqishme në botë në misione nga Afganistani e deri në Mali.*



TAKIMI I SHEFAVE TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM, TË VENDEVE ANTARE TË NATO-s

## Gjeneralmajor Bajram Begaj në sesionin e 184 të Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefat e Shtabeve të vendeve të Aleancës u “mblodhën” virtualisht më 18 shtator 2022, në sesionin e 184 të Komitetit Ushtarak. Takimi u drejtua nga Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, kryetar i Komitetit Ushtarak, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Tod Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin, (SACT), gjeneral André Lanata.

SHSHP të vendeve të NATO diskutuan për një sërë çështjesh që lidhen me angazhimet operationale aktuale të NATO (Resolute Support Mission, misionin e NATO në Irak, misionin e KFOR), për Deterrence and Defence të hapësirës euroatlantike dhe çështjeve të tjera që lidhen me misionin e NATO. Ata diskutuan gjithashtu përparimin në zhvillimin e një koncepti kyç të NATO-s për armiqësitë, si dhe mësimet e nxjerra



nga roli i organizatës në luftën kundër COVID-19. Njëzëri të gjithë shefat rikonfirmuar qëndrimin e vendeve anëtare për vijueshmërinë e mbështetjes për misionet dhe operacionet në bazë të

vendimmarrjeve politike, ndërsa mbi zbatimin e konceptit Deterrence and Defence të hapësirës euroatlantike, shefat e SHP vlerësuan punën e bërë nga komandat strategjike, transpar-

encën mbi hartimin e këtyre dokumenteve dhe ofruan këshillim ushtarak mbështetur në pikëpamjet kombëtare.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj rikonfirmoi vijimin e kontributeve të

Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës. në veçanti vlerësoi misionin e NATO-s në Kosovë si suksesin më të madh të NATO-s që prej krijimit të saj në fushën e operacioneve. Kjo ishte pjesëmarrja e parë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, në këtë post të lartë ushtarak, në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s (KP).

Komiteti Ushtarak i NATO-s në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mblidhet dy herë në vit në Shtabin e NATO-s në Bruksel, dhe një takim, me rotacion, një herë në vit në një nga vendet anëtare të Aleancës. Takimi i radhës do të jetë në Greqi në shtator 2021



Në mjesditet e Batalionit Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, u zhvillua ditën e martë më 22 shtator 2020, ceremonia e gradimit të gjeneral brigade Arben Kingji, të cilit iu akordua grada madhore me dekret të presidentit të Republikës, me propozim të ministres së Mbrojtjes.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, komandantë forcash, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP, si dhe ushtarakë të lartë e të ftuar të tjerë.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Olta Xhaka, pasi falënderoi të gjithë të pranishmit në këtë ceremoni, duke e konsideruar këtë ditë shumë të veçantë jo vetëm për faktin që sot do i vendosim gradat gjeneral brigade Kingji, por se kjo ditë përkon edhe me 55 - Vjetorin e Krijimit të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Shtabit në Përgjithshëm.

Ministrja Xhaka vlerësoi përkushtimin dhe profesionalizmin gjeneral brigade Arben Kingji duke e cilësuar si një ndër ushtarakët më të spikatur të Forcave të Armatosura.

“Gjeneral brigade Arben Kingji ka bërë një punë të shkëlqyer kudo ku ka shërbyer, si komandant në Batalionin “Komando”, në Forcat Speciale, në Policinë Ushtarake, atashë ushtarak jashtë vendit e, së fundmi, komandant i Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm në FA.”, u shpreh ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaka.

“Meritokracia-theksoi ministrja Xhaka - bazuar në profesionalizëm, pasionin e përkushtimin do të jetë guri i themelit për një Forcë të Armatosur profesioniste e të mirëorganizuar.” Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Arben Kingji duke e konsideruar këtë ditë shumë të veçantë si dhe nder dhe privilegj për të dhe familjen e tij, falënderoi ministren Xhaka për vlerësimin dhe besimin si dhe kolegët, duke u angazhuar se do ta mbajë me nder dhe përkushtim gradën e dhënë.



Kjo ditë përkon me 55-Vjetorin e Batalionit të Mbështetjes

# Ministrja e Mbrojtjes Xhaka gradon gjeneral brigade Arben Kingji

*Meritokracia bazuar në profesionalizëm, pasionin e përkushtimin do jetë guri i themelit për një Forcë të Armatosur profesioniste e të mirëorganizuar*



“Gjeneral brigade Arben Kingji ka bërë një punë të shkëlqyer kudo ku ka shërbyer, si komandant në Batalionin “Komando”, në Forcat Speciale, në Policinë Ushtarake, atashë ushtarak jashtë vendit e, së fundmi, komandant i Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm në FA”.

CINCU, RUMANI: 14 DERI MË 25 SHTATOR 2020

## Përfundon stërvitja “Carpathian Eagle 20”

Morën pjesë trupa nga 6 vende të Ballkanit: Shqipëri, Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi, Maqedoni e Veriut

Nga data 14 deri më 25 shtator 2020 në rajonin stërvitor Joint National Training Center në Cincu, Rumani u zhvillua stërvitja “Carpathian Eagle 20”.

Kjo stërvitje u realizua me pjesëmarrjen e 6 vendeve të Ballkanit: Shqipëri, Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi, Maqedoni e Veriut. Stërvitje u zhvillua në nivel grupi special dhe shtab STOG, i



cili ishte i përzier me personel nga të gjitha vendet pjesëmarrëse. Gjatë kësaj stërvitje u zhvilluan këto tema: qitje, LQB, air assault (fast rope, dylfer) shëndetsi, xhenio, etj. Kjo stërvitje ndërmjet Forcave Speciale kishte si qëllim forcimin e mëtijshëm të ndërveprueshmërisë në operacionet e spektrit të plotë për Forcat Speciale.



## Trupat shqiptare në KFOR nderohen me medaljen e NATO-s

Trupat shqiptare në KFOR janë nderua të enjte, më 17 shtator 2020, me medaljen e NATO-s. Medalja e marrë nga trupat shqiptare vjen për shërbimin e realizuar në misionin e Aleancës për një vend më të sigurt. Lajmi për marrjen e medaljes e ka dhënë ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaka, e cila ka publikuar dhe foton e momentit të dorëzimit të medaljes nga përfaqësues të NATO-s tek trupat shqiptare. “Trupat shqiptarë në Kosovo Force-KFOR nderohen me medaljen e NATO-s, për shërbimin e tyre në misionin e Aleancës për një vend më të sigurt. Ne jemi NATO”, theksoi Xhaka.



## Efektivët e BMR neutralizojnë zjarrin në malin e Dajtit

Efektivët e Batalionit të Mbeshtetjes Rajonale (BMR) të KM i janë përgjigjur menjëherë situatës së ri krijuar nga zjarret në zonën e Priskës pranë malit të Dajtit. Me marrjen e sinjalit të emergjencës së rënies së zjarreve nga Qendra e Bashkuar Operacionale, Efektivët e BMR janë përgjigjur në kohë rekord thirrjes për shuarjen e 3 vatrave masive të

rene në një teren tepër të vështirë. Në këtë operacion u përfshirë 3 mjete dhe 20 trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuara për shuarjen e zjarreve. Angazhimi i Batalionit të Mbeshtetjes Rajonale të Komandës Mbeshtetëse do të vazhdojë deri në përmirsimin e situatës së krijuar nga zjarret e rene ditët e fundit në shkallë vendi.



### AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

## Mbaron afati për aplikimet në Akademinë e Forcave të Armatosura

*Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrat e Aleancës ku ne bëjmë pjesë*

Më 21 shtator në mesnatë është mbyllur afati i fundit i raundit të dytë për aplikimet në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ky fakt është bërë i ditur nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. Përmes një postimi në "Facebook", Xhaçka thekson se për çdo student që do të vijojë shkencat ushtarake në AFA, do të ketë një pagesë mujore.

"Sot në mesnatë është afati i fundit i raundit të dytë për aplikimet në universitete. Për të gjithë maturantët që nuk aplikuan në raundin e parë, atyre që kaluan me sukses provimet e vjeshtës dhe maturantëve të viteve të shkuara, Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi fantastike arsimimi. Deri sot në mesnatë, përmes aplikimit në ualbania.al mund të zgjidhni shkencat ushtarake në AFA, si rrugëtimin tuaj, për vetë kushtet e ofruara: Pagesë mujore ndihmëse për çdo student për të gjithë periudhën e studimit akomodim dhe ushqim falas për 3 vitet e studimit në Akademi, tarifë studimi 0 lekë në vit, punësim i sigurt pas përfundimit të studimeve", shkruan Xhaçka.

Më 28 gusht 2020 ka përfunduar Raundi i parë i aplikimit dhe regjistrimit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) në programin e studimeve në fushën e Shkencës Ushtarake ku janë shpallur edhe fituesit. Në përfundim të Raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura. Në tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA. Ky është edhe momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA, duke shërbyer në këtë mënyrë si një institucion i mirëfilltë publik i arsimit të lartë!

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur kuadro më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të thithur talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërtuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrat e Aleancës ku ne bëjmë pjesë.



*Për të gjithë maturantët që nuk aplikuan në raundin e parë, atyre që kaluan me sukses provimet e vjeshtës dhe maturantëve të viteve të shkuara, Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi fantastike arsimimi.*

### DO KRIJOJMË BASHKËPUNIM ME FORCAT AJRORE RUMUNE

## Atasheu ushtarak i Rumanisë kolonel Valerica Piroasca vizitë te Forcat Ajrore

Në Komandën e Forcës Ajrore atasheu ushtarak i Rumanisë kolonel Valerica Piroasca u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj. Pasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Ajrore, kolonel Pulaj e njohu atasheun rumun me strukturën, kapacitetet dhe projektet kryesore të Forcës Ajrore. Nga ana e tij, atasheu rumun bëri një ekspozë të shkurtër të Forcës Ajrore rumune dhe u shpreh se deri tani nuk kemi patur bashkëpunim në fushën Ajrore por do të shikohet mundësia e bashkëpunimit dypalësh ushtarak në fushat Arsimimit dhe Trajnimit të personelit pilot dhe teknik në të ardhmen. Në përfundim të vizitës, kolonel Pulaj siguroi atasheun ushtarak rumun se Komanda e Forcës Ajrore do të jetë e gatshme të mirëpresë, t'i studiojë e, pse jo, t'i realizojë ofertat e ardhura nga pala rumune, duke respektuar gjithmonë shkallën e hierarkisë.







PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**Nder dhe privilegj të shkruash  
për shekullorin Ziqiri Mero**

Ditë më parë mora një libër dhuratë nga shekullori Ziqiri Mero, ku në dedikim më theksonte “një jetëgjatësi si unë”. Libri titullohet “I fundmi gjeneral partizan” i shkruar nga Dilaver Goxhaj, luftëtari nga Shqipëria që ishte gjatë gjithë kohës së Luftës së Kosovës, pjesë e UÇK-së. Gjuha e thjeshtë dhe ndërtimi i veçantë i kësaj monografie, na sjellin jetën 100 vjeçare të bërë prej një gjenerali partizan. Libri nis me një prolog që siç ka thënë oficeri ndërlidhës britanik gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri Reginald Hibbert “po të kisha qenë shqiptar, unë do të isha bërë partizan”.

Pastaj autori për ta futur sa më natyrshëm lexuesin e interesuar jep njohuri përmbledhëse për krahinën e Devollit ku lindi dhe u rrit kundëradmirali Ziqiri Mero. Thjesht e qartë tregon se kush është Ziqiri Mero, si u prit 7 prilli nga normalistët e Elbasanit. Në libër ka një intervistë rreth Luftës së Leskovikut, kronika episodesh nga jeta e kundëradmiralit Ziqiri Mero, si dhe veprimtari të tij. Libri mbyllet me të tjerë për Ziqiri Meron të shkruar nga Hetem Halili, Bashkim Koçi, Dhimitër M. Xhoga, Myfit Qorduka, Bernard Zotaj, shoqata e “Detaria shqiptare”, Mëhill Marku, Sevo Tarifa, Artan Lame etj.

Monografinë për gjeneralin e thjeshtë dhe fjalëpakë, Ziqiri Mero, autori Dilaver Goxhaj e pranoi me kënaqësi, dhe se ishte një privilegj që i bëhej. Autori thotë se më është bërë nder dhe privilegj ngaqë Ziqiri Mero është gjenerali i fundit që karrierën e tij si kuadër ushtarak e ka fituar dhe justifikuar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke u emëruar komisar kompanie që në ditën e parë të krijimit të formacionit të parë të Ushtrisë së Rregullt Partizane, Brigadës së Parë Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Sulmuese. Brigadat partizane u quajtën sulmuese, për t'i thënë popullit se nuk mund të ketë luftë çlirimtare duke zhvilluar luftime mbrojtëse sikundër ishte vepruar në shumicën e veprimeve luftarake të deriatëhershme. Atdheu u çlirua vetëm nga partizanët duke e sulmuar pushtuesin në vijimësi.

**Fitoren simbol e arritën  
partizanët me Ziqiri Meron**

Monografinë për partizanin Ziqiri Mero e ka shkruar djali i një bashkëluftëtari të veteranit, pasardhës i luftëtarëve të LANÇ-it, dhe nip dëshmorit të asaj lufte famëmadhe çlirimtare.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e Shqipërisë 1939-1944, ishte një provë e madhe për popullin shqiptar, ngjarja më e madhe në historinë e

# Autorë ushtarakë

## “I fundmi gjeneral partizan” ose 100 vite në një libër



kombit tonë, për faktin se ishte një luftë popullore për liri, ishte një luftë e cila i riktheu Shqipërisë pavarësinë e grabitur, ku u ndeshën forca përparimtare me reaksionin botëror dhe vendas, ishte një luftë drejt progresit, ngaqë pas saj, Shqipëria u rindërtua me shpejtësi dhe se populli shqiptar u çlirua i pari në të gjithë kompleksin e luftës së aleatëve antifashistë. Populli shqiptar me forcat e veta, edhe pse ishte populli i parë në Evropë që iu përgjigj me armë fashistëve zaptues kur shkelën tokën e tij më 7 prill 1939.

Autori thekson me forcë se në Evropë nuk gjendet një popull që iu përgjigj me armë pushtimit fashist në vitet 1939-1940, por dhe të jetë çliruar

me forcat e veta. Si e tillë, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ku i fundmi partizan e gjeneral Ziqiri Mero është shndërruar në simbol, në kult të Atdheut. Sot më tepër se kurrë mbrojtja e LANÇ-it është akti më patriotik veçanërisht, kur politikanët e 30 viteve po bëjnë të pamundurën ta fshijnë nga historia këtë ngjarje epepe. Mbrojtja e periudhës së historisë të Atdheut është për ne e rëndësishme si mbrojtja e kufijve shtetërore, shprehet autori.

Këtë fitore simbol e arritën partizanët me Ziqiri Meron, nuk e arritën kolaboracionistët, bashkëpunëtorët e nazifashistëve, tradhëtarët dhe indiferecentët. Në këto vite qeveritë shqiptare të të gjithë spektrit politik u përgjësua

dhe përgjësua për të ngritur kufomat e kësaj lufte. Kjo luftë e tmerrshme dhe e pandërprerë nga të gjitha drejtimet, për antifashistët dhe partizanët kishte pati dy rrugë: o fitoren e pavarësisë, o vdekjen e Shqipërisë. Ata zgjodhën fitoren e pavarësisë.

Deri në vitin 1991, të shek. XX Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare përkujtohej me nderime të veçanta, ku organizoheshin sesione shkencore, bëheshin botime nga institucione shkencore, u botuan histori të asaj, historikë të formacioneve të UNÇSH, u bënë romane, novela, drama, poezi, këngë, uvertura, kompozime, u prodhuan filma, piktura, skulptura etj., të gjitha kishin një qëllim, pasqyrimin e luftës siç edhe u zhvillua.

**Unë e sfidova pleqërinë...**

Kundëradmirali Ziqiri Mero festoi 100-vjetorin e lindjes në kohën e vështirë të COVID-19. 100 vjetorin e festoi thjesht, si 100 vite më parë kur lindi në Devoll. Ai ju gëzua këtij 100 vjetori shëndetit të tij. Pleqërinë e kam larguar vite më parë, kur u mora me aktivitete, ka thënë diku në libër. Faktikisht, kundëradmirali 100-vjeçar, me aktivitetin e tij fizik dhe intelektual e sfidoi dhe vërtetoi se pleqëria nuk e largoi nga jeta aktive, por pranoi si teori pa vërtetim se veprimtaria publike mund të bëhet edhe në moshë shumë të thyer.

Pleqëria i dobëson forcat fizike të trupit, por nuk dobëson jetën shpirtërore. Këtë sfidë Ziqiri ja ka bërë dhe ja bën pleqërisë. Cicero ka thënë se punët e mëdha nuk bëhen me forcë, me shpejtësi apo me shkathtësinë e trupit, por me urtësi, me autoritet dhe me prestigj, pleqërisë nuk i mungojnë këto virtyte, përkundrazi, është më e pasur me to.

Në monografi ka disa intervista dhe biseda të herëpashershme të autorit me Ziqiriun, të cilat janë pasqyruar mjaft bukur në libër. Biseda në një rast shkoi edhe te pyetja, për kujtesën dhe hollësitë rreth ngjarjeve. Ziqiri befason me përgjigjen e tij. Ai zbaton edhe sot një lloj metode që jua përsërisnin shpesh herë mësuesit e shkollës Normale të Elbasanit, e që quhet metoda pitagoriane. Për të ushtruar atë, kujtesën, thekson Ziqiri, kaloj në mendje gjatë mbrëmjes së vonë ato çfarë kam thënë gjatë ditës, çfarë kam dëgjuar nga bashkëbiseduesit ose nga lajmet që më kanë bërë përshtypje, si dhe çfarë kam lexuar atë ditë... Kjo mendoj se quhet gjimnastika e intelektit, por që ndryshe i thonë ushtrimet e mendjes, kjo metodë më ka ruajtur kujtesën.

Unë e sfidova pleqërinë edhe me biseda të ndryshme me bashkëmoshatarët, pasi “kur ke mendime

të ngjashme bashkohesh lehtë me bashkëbiseduesin”. Por shton më tej se i është mirënjohës pleqërisë, se më ka shtuar dëshirën e bisedimit dhe më ka hequr pijen dhe të ngrënë. Ziqiriut i pëlqen ngritja e dollisë nëpër gosti të ndryshme dhe në rrethe shoqërore, siç është traditë edhe në Devoll, pavarësisht se këtë kënaqësi nuk janë me bollëk në këtë moshë... Këto më pëlqejnë dhe për faktin se bëhen biseda të këndshme përpara gotës së rakisë, kryesisht, me miq e shokë të moshës së tretë e të thellë, duke folur secili me radhë, duke e shtyrë gostinë sa më gjatë, sa më shumë që të jetë e mundur.

Ja pra, thotë Ziqiri, kjo është pleqëri e qetë dhe tregon se kështu kundëradmirali po plaket duke nxënë më shumë gjëra nga dita në ditë, sepse kjo është kënaqësia e shpirtit.

**Shtylla dinjitoze e  
Organizatës së Veteranëve**

Partizani dhe komisar Ziqiri Mero, me Brigadën e Parë Sulmuese u kthye nga operacioni i spastrimit të Malësisë së Madhe, ditën kur mbushi 25 vjeç. Me mbërritjen në Tiranë, emërohet punonjës për propagandën në Drejtorinë Politike të Ushtrisë. Më tej emërohet komisar i Divizionit të Këmbësorisë në Korçë dhe më pas i Divizionit të Këmbësorisë në Tiranë. Ndërsa në vitet 1950-1955 Ziqiri ndjek studimet e larta në Akademinë Ushtarako-Politike “Lenin”, në Moskë dhe me kthimin nga studimet në Bashkimin Sovjetik, emërohet komisar i Korpusit të Këmbësorisë në Elbasan, për t’u emëruar pas dy vjetesh komisar i Mbrojtjes Bregdetare në Durrës. Në vitin 1960 emërohet Komisar i Flotës Luftarake Detare, me qendër në Vlorë dhe në vitin 1961 gradohet Gjeneralmajor (Kundëradmiral).

Në vitin 1967 emërohet zëvendësudrejtor i Drejtorisë Politike dhe në vitin 1973 emërohet komisar i Akademisë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Pas ngjarjeve që ndodhen në vitin 1974, emërohet në Vlorë komisar i Akademisë Ushtarake të Flotës Luftarako-Detare, derisa doli në pension. Për merita të shquara gjatë luftës dhe për kontribut të vyer në shërbim të atdheut e ushtrisë, Ziqiri Mero është dekoruar disa herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Sot Ziqiri Mero është një nga shtyllat më dinjitoze të Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe këshilltari kryesor i saj.



## Batalioni i Xhenios (bXh)

## Përfundon stërvitja e koduar "Macukulli 2020"

*Stërvitja ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore për fshatrat, Vig, Shëlli dhe Shtjefn dhe për 2000 banorët e kësaj zone*

Nga data 01 deri më 20 shtator, në rajonin e Macukullit bashkia Burrel u zhvillua stërvitja e koduar "Macukulli 2020". Kjo stërvitje, e cila u zhvillua nën drejtimin e Batalionit të Xhenios (bXh) dhe mbështetje e batalioneve të Furnizimit, Transportit dhe Mbështetjes Rajonale, si dhe pushtetit lokal të këtij rajoni, u realizua në zbatim të planit të aktiviteteve kryesore vjetore të Komandës Mbështetëse dhe FA, me qëllim rritjen e nivelit operacional të forcave xheniere, si dhe forcimin e mëtejshëm të nivelit të bashkëpunimit të Komandës Mbështetëse me pushtetin lokal, për ndërtimin e një segmenti rrugor prej 9 km. Pas planëzimit të detajuar të kësaj stërvitje, u krye lëvizja e forcave dhe mjeteve, ngritja e fushimit me elementët përkatës në rajonin e Macukullit.

Pas vendosjes së kontakteve dhe një organizimi të mirë me pushtetin lokal, u bë i mundur realizimi me sukses i detyrës për hapjen dhe rehabilitimin e segmentit rrugor "Shtjefn-Macukull".

Gjatë punimeve për rehabilitimin e segmentit rrugor, punimet u inspektuan nga vetë komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, i cili falënderoi efektivat për punën e pa lodhur dhe në kushte të vështira infrastrukturore.

Kjo ishte një stërvitje e rëndësishme së veçantë për kontributin e rrallë që solli në përmirësimin e infrastrukturës rrugore për fshatrat, Vig, Shëlli dhe Shtjefn dhe 2000 banorët e kësaj zone.



## BATALIONI III I KËMBËSORISË (B3K)

## Zhvillohet stërvitja 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20"

Batalioni III i Këmbësorisë (b3k) nga data 15 deri më 17 shtator, zhvilloi stërvitjen 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20". Kjo stërvitje kryhet për të testuar dhe përmirësuar kapacitetet për kryerjen e detyrave në kuadër të operacioneve të mbështetjes së paqes si dhe ruajtjes së gatishmërisë.

Stërvitja u zhvillua në nivel kompanie, ku efektivet pjesëmarrës të Kompanisë III të b3k realizuan skenarë të ndryshëm, ditën dhe natën. Trupat testuan aftësitë për krijimin e pikave të kontrollit në mjedise jo të sigurta dhe terren të panjohur, shpërndarjen e turmave në situata të tensionuara, goditjen e objektit, brenda të cilit ka elementë të rrezikshëm, patrullimin si në këmbë dhe me mjete, e deri te bashkëpunimi me pushtetin lokal në zonën e



operacionit. Stërvitjet në kuadër të operacioneve të mbështetjes së paqes do të vazhdojnë në b3k

me stërvitjen "Shigjeta 20", e cila do të zhvillohet në muajin tetor me Kompaninë I.

## Batalioni i Xhenios (bXh) në Komandën Mbështetëse



## Eliminohen predhat e kalibrave 76 mm dhe 122 mm

Struktura speciale për eliminimin e materialeve të rrezikshme EOD e Batalionit të Xhenios (bXh) në Komandën Mbështetëse sapo ka përfunduar me sukses dy operacione EOD përkatësisht në bashkinë Gjirokastrë dhe njësinë administrative Orikum të bashkisë Vlorë për identifikimin, heqjen dhe transportimin e municioneve, tip predha të kalibrave 76 mm dhe 122 mm.

Specialistët EOD pasi evidentuan prezencën e municioneve luftarake, konstatuan se municioni i gjetur në njësinë administrative Orikum ishte predhë e kalibrit 76 mm, e cila i përkiste Luftës së Dytë Botërore, ndërsa predha e kalibrit 122 mm u gjend në zonën industriale Gjirokastrë dhe i përkiste periudhës së vitit 1997. Të dyja këto municione u hoqën dhe u transportuan kundrejt rregullave dhe procedurave standarde duke eliminuar kështu rrezikun për popullsinë.



## SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S JENS STOLTENBERG

# Stoltenberg: NATO-2030 ka të bëjë me të ardhmen e Aleancës

*NATO ka një qasje globale, por sfidat me të cilat përballemi sot na kërkojnë të shkojmë edhe më tej*

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mbajti një fjalim kryesor online mbi “Hartësimin e Dekadës së Re Transatlantike” në Forumin e 12-të vjetor të Forumit të Analizës së Politikës Evropiane (CEPA) të hënën (21 shtator 2020). Sekretari i Përgjithshëm theksoi tre përparësitë e tij për procesin e reflektimit të NATO 2030, përkatësisht mbajtjen e NATO-s të fortë ushtarakisht, duke e bërë NATO-n më të fortë politikisht dhe duke siguruar një qasje më globale për NATO-n.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO 2030 ka të bëjë me të ardhmen e Aleancës. Ai nënvizoi vendosmërinë e tij për të marrë parasysh idetë dhe shqetësimet e të rinjve dhe rëndësinë e angazhimit me ta për të diskutuar sfidat e reja me të cilat përballlet NATO.

Duke përmendur vlerën e NATO-s si një platformë unike politike, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO është e vetmja organizatë që bashkon vende në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut për të diskutuar çështje sigurie me interes të përbashkët. Z. Stoltenberg paralajmëroi se kërcënimet ush-



tarake që ekzistonin para pandemisë nuk janë zvogëluar dhe theksoi rëndësinë e vazhdimin të investimeve në forcat e armatosura, për të ndërtuar shoqëri më të forta dhe më të sigurta për të gjithë.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO tashmë ka një qasje globale, por sfidat me të cilat përballemi sot na kërkojnë të shkojmë edhe më tej. Ai theksoi rëndësinë e punës së ngushtë me vendet dhe organizatat me të njëjtin mendim për të mbrojtur vlerat e NATO-s në një botë të konkurrencës globale në rritje. Forumi vjetor CEPA, një konferencë udhëheqëse e sigurisë transatlantike, bashkon vendimarrësit e qeverisë dhe biznesit, me ekspertë të lartë të sigurisë dhe politikave, ku pjesëmarrësit debatojnë për sfidat me të cilat përballlet aleanca transatlantike.

## Stoltenberg-Sánchez: Spanja është qendra ndihmëse e NATO-s

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Kryeministrin spanjoll Pedro Sánchez të mërkurën (23 shtator 2020) dhe përgëzoi popullin spanjoll për qëndrueshmërinë e tyre gjatë krizës COVID 19. Duke nënvizuar që Spanja “nuk ka qëndruar vetëm” gjatë krizës COVID 19, ai tha se qendra e ndihmës së NATO-s për koordinimin e katastrofave koordinonte ndihmën për Spanjën dhe se aleatët e NATO-s dhanë furnizime mjekësore, duke ndihmuar në lehtësimin e barrës në sistemin spanjoll të kujdesit shëndetësor dhe shpëtimin e jetës. “Unë i nderoj

forcat e armatosura spanjolle që kanë mbështetur përpjekjet civile gjatë pandemisë. Kjo provon edhe një herë rëndësinë e mbajtjes së ushtrive tona të forta”, tha Z. Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Kryeministrin për angazhimin e vazhdueshëm të Spanjës në misionet e NATO-s dhe operacionet në Afganistan dhe Irak, si dhe në grupin shumëkombësh të betejës në Letoni dhe Policimin e Ajrit mbi Balltik.

Duke folur për zhvillimet në Mesdheun Lindor, z. Stoltenberg azhurnoi Kryeministrin Sánchez mbi diskutimet e tij të fundit të nivelit

të lartë mbi këtë temë me Ankarën dhe Athinën. Sekretari i Përgjithshëm tha se ai mbetet në kontakt të ngushtë me udhëheqjen greke dhe atë turke dhe mirëpriti mbështetjen e Spanjës për përpjekjet e NATO-s për de-konfliktimin. Duke folur për procesin e reflektimit të NATO-s 2030, z. Stoltenberg tha se “kjo ka të bëjë me mbajtjen e Aleancës sonë të fortë ushtarakisht, duke e bërë atë më të fortë politikisht dhe duke e bërë atë më globale” dhe theksoi se një partneritet i fortë me Bashkimin Evropian është një pjesë e rëndësishme e saj, “sepse forcon aleatët e BE dhe forcon NATO”.



## Trupat e NATO-s dhe Finlandës punojnë krah për krah

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mirëpriti ministrin e Jashtëm finlandez Pekka Haavisto në Selinë e NATO-s për herë të parë të hënën (21 shtator). Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi partneritetin e ngushtë midis NATO dhe Finlandës, dhe falënderoi ministrin për kontributet e Finlandës në operacionet dhe stërvitjet e NATO-s. Ai vuri në dukje se trupat e NATO-s dhe Finlandës vazhdojnë të punojnë krah për krah në misionet e NATO-s në Afganistan, Kosovë dhe Irak.

Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri Haavisto diskutuan përfitimet e ndërsjella të partneritetit NATO-Finlandë dhe ranë dakord mbi nevojën për të vazhduar punën ngushtë për një sërë çështjesh, duke përfshirë sigurinë e Detit Baltik dhe luftën kundër kërcënimeve hibride. Sekretari i Përgjithshëm dhe ministri shkëmbyen gjithashtu mendime mbi Bjellorusinë, situatën në Mesdheun Lindor, bashkëpunimin NATO-BE, ndikimin e ndryshimit të klimës në mjedisin e sigurisë dhe zhvillimet në Arktik. Ata shfrytëzuan rastin për të diskutuar procesin e reflektimit të NATO-s 2030 për të forcuar NATO-n. Z. Stoltenberg theksoi se angazhimi me partnerët është i rëndësishëm në këtë proces.





SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S JENS STOLTENBERG

# Turqia dhe Greqia do të zhvillojnë bisedime diplomatike

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg bisedoi të mërkurën (23 shtator 2020) me telefon me Presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan për situatën në Mesdheun Lindor. Sekretari i Përgjithshëm përsëriti rëndësinë e dialogut dhe de-përshkallëzimit dhe theksoi se situata duhet të zgjidhet në një frymë solidariteti aleat dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Delegacionet ushtarake nga Turqia dhe Greqia janë takuar gjashtë herë në Selinë e NATO-s në Bruksel si pjesë e një iniciative të udhëhequr nga Aleanca për krijimin e mekanizmave të konfliktit për të

parandaluar incidentet dhe aksidentet në det ose në ajër. Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se është bërë përparim në bisedime, duke theksuar se zhvillimi i mekanizmave të de-konfliktit midis ushtrive është një rol i natyrshëm për NATO-n. Z. Stoltenberg përshëndeti gjithashtu njoftimin se Turqia dhe Greqia do të zhvillojnë bisedime diplomatike eksploruese. Si pjesë e konsultave të tij të rregullta me udhëheqësit nga Turqia dhe Greqia, Sekretari i Përgjithshëm ka biseduar të enjten (24 shtator 2020) me Kryeministrin Grek Kyriakos Mitsotakis.



FORCAT AJRORE AMERIKANE

## Katër avionë A-29 Super Tocano për forcat Ajrore Afgane

*Këshilltarët e SHBA dhe Koalicionit ofrojnë trajnim, këshilla dhe ndihmë për forcat ajrore afgane nga niveli ministror deri në krahët, grupet dhe nivelet e skuadriljes*

SHBA dorëzon katër avionë në Forcën Ajrore Afgane, si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme të NATO-s për forcat afgane të sigurisë, më 17 shtator 2020. Shtetet e Bashkuara, si një komb kontribues në Misionin e Mbështetjes së Vendosur të udhëhequr nga NATO, transferuan katër avionë A-29 Super Tucano në Forcën Ajrore Afgane, gjatë një ceremonie në Kabul. “Ndërsa marrim këto aeroplanë, ato janë një mesazh që NATO është e përkushtuar ndaj Forcave Afgane,” tha ministri në detyrë i Mbrojtjes Asadullah Khalid. “Gjatë këtyre kohërave të rëndësishme, ky është një shembull i mirë i bashkëpunimit të tyre të vazhdueshëm dhe tregon se kjo do të vazhdojë deri në mposhtjen e terrorizmit në vend dhe rajon.”

A-29 është aeroplani më i shpejtë dhe më i fuqishëm i forcave ajrore afgane dhe aeroplanët e sulmit në ajër. SHBA deri tani ka siguruar 18 A-29 Forcave Ajrore Afgane që nga viti 2016 dhe planifikon të transferojë një shtesë në shkurt 2021. “Unë ju përgëzoj të gjithëve për pranimin e këtyre aeroplanëve të rinj,” i tha ministri Khalid një asambleje të madhe të pilotëve dhe zyrtarëve të sigurisë. “Shpresoj se ata do të fluturojnë ditë e natë nëse është e nevojshme në mënyrë që të mbrojnë vendin tonë.”

Që nga viti 2007, NATO ka punuar për të rindërtuar dhe modernizuar Forcën Ajrore Afgane, së pari me Forcën Ndërkombëtare të Ndihmës së Sigurisë (ISAF), dhe pastaj nën Misionin e Mbështetjes së Vendosur, i cili filloi në 2015. Këshilltarët e SHBA dhe Koalicionit ofrojnë trajnim, këshilla dhe ndihmë për forcat ajrore afgane nga niveli ministror deri në krahët, grupet dhe nivelet e skuadriljes. “Objektivi i NATO-s në Afganistan ka qenë gjithmonë mohimi i parajsave të sigurta për terrorizmin ndërkombëtar,” tha gjenerallejtënant John Deedrick, komandant i Komandës së



Kombinuar të Sigurisë së Afganistanit për Afganistanin. “Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është gjenerimi i for-

cave afgane të sigurisë kompetente, të trajnuara dhe profesionale të cilat mund të ruajnë sigurinë në mënyrë të

pavarur. Ndërsa punojmë drejt paqes, Misioni i Mbështetjes së Vendosur të udhëhequr nga NATO vazhdon të

punojë ngushtë me të gjitha degët e Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcave të Sigurisë Afgane.”


Që nga viti 2015, përpjekjet e modernizimit të Rezolutës së Ndihmës kanë ndihmuar në transformimin e Forcave Ajrore Afgane në disa nga forcat më të afta të sigurisë në Afganistan. Si rezultat i përpjekjeve të këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës së udhëhequr nga NATO, Forca Ajrore Afgane tani në mënyrë të pavarur planifikon dhe ekzekuton misionet e logjistikës, furnizimit, ndihmës humanitare, evakuimit të viktimave dhe mbështetjes luftarake. “Edukimi, trajnimi dhe përvoja që Forcat Ajrore Afgane, Ushtria Afgane dhe Forcat tona Speciale kanë fituar në vitet e fundit është unike në rajon,” tha ministri Khalid. “Ndjenja e përkushtimit dhe moralit, e cila është më e rëndësishme se gjithçka, është e fortë tek ushtarët dhe të rinjtë e këtij vendi, dhe ne jemi gjithmonë dëshmitarë të kësaj.” Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje përparimet në forcat e sigurisë janë vetëm një pjesë e fitimeve që vendi ka bërë gjatë 19 viteve të fundit përmes bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare. “Në dy dekadat e kaluara, ne kemi parë rindërtimin e vendit, arsimimin e të rinjve, pavarësinë e Afganistanit dhe arritje të tjera të tilla si media e lirë që sot po dëshmojmë këtu me disa kamera të pranishme”, tha ministri Khalid. Ai përfshiu rritjen e rolit të grave në ato arritje. “Në dy dekadat e fundit, gratë afgane kanë fluturuar në qiell, janë bërë pilote, mjekë, mësuese, ministre dhe zëvendësmistre dhe ato nuk do të kthehen më në ato ditë të së kaluarës.”

## Bashkëpunimi NATO-BE në adresimin e sfidave të sigurisë

Në një takim ballë për ballë të mërkurën (23 Shtator), Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg dhe Zëvendës Presidentja Ekzekutive e Komisionit Evropian Margrethe Vestager theksuan rëndësinë e bashkëpunimit NATO-BE në adresimin e sfidave të sigurisë që dalin nga teknologjitë e reja të tilla si të dhëna, artificiale inteligjencën dhe rrjetet e gjeneratës së ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm tha se pandemia COVID-19 e ka bërë partneritetin NATO-BE më të rëndësishme se kurrë, kështu që rritja e rezistencës, përfshirë në fushën dixhitale, është një përparësi si për NATO-n ashtu edhe për BE-në. Zonja Vestager gjithashtu u bashkua me Këshillin e Atlantikut të Veriut për diskutime të mëtejshme mbi sfidat e reja teknologjike.







Objektivi i përbashkët i kësaj iniciative është rritja e bashkëpunimit të mbrojtjes, duke përfshirë bashkimin dhe ndarjen e aftësive mbrojtëse të vendeve anëtare si dhe organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Kosova këtë radhë u ftua së bashku me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi që sesioni i sivjetëm i konferencës u fokusua në identifikimin e rrugëve të mundshme për një dialog të zgjeruar të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së.



Kosova në Bashkëpunimin Evropian Qendror të Mbrojtjes (CEDC)

# Stërvitje të përbashkëta me aktorë rajonalë dhe evropianë

*Bashkëpunimi Evropian Qendror i Mbrojtjes (CEDC) është iniciativë e bashkëpunimit ushtarak i përbërë nga shtetet e Evropës Qendrore të Austrisë, Çekisë, Sllovakisë, Hungarisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Polonisë me status vëzhguesi*

**M**e ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë, si nikoqir, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Faruk Geci dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha, më 16 shtator 2020, morën pjesë në punimet e Konferencës vjetore të Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore (The Central European Defence Cooperation-CEDC). Bashkëpunimi Evropian Qendror i Mbrojtjes (CEDC) është iniciativë e bashkëpunimit ushtarak i përbërë nga shtetet e Evropës Qendrore të Austrisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, Hungarisë, Sllovenisë dhe Kroacisë dhe Polonisë me status vëzhguesi.

